



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

Konferenca Ndërkombëtare e Grave Sipërmarrëse me Fokus Biznesin Familjar

Nga Flutura Xhabija

Më 14 korrik 2017 në Podgoricë u zhvillua Konferenca Rajonale, për Evropës Jug Lindore, e Grave Sipërmarrëse dhe Artizane. Në rrjetin Rajonal të Grave Sipërmarrëse dhe Artizane bëjnë pjesë shoqata nga 8 vende si: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Ukraina dhe Bullgaria. Në këtë Konferencë morri pjesë edhe një delegacion i Shoqatës Kombëtare të Grave Profesioniste, Afariste dhe Zejtare. SHGPAZ është shpirti dhe motor i rëndësishëm në rrjetin e organizatave të E.J.L. Në çdo moment shoqata vijon detyrën, në dobi të vendit tonë, të grave sipërmarrëse, të grave artizane, të sipërmarrjes në përgjithësi dhe zhvillimit social-ekonomik, përdite me hapin e kohës. Gjatë konferencës u trajtuan tema mjaft interesante,

të përzgjedhura me kujdes nga eksperte gjermane dhe bullgare, në lidhje me zhvillimin e biznesit familjar, kontributin në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe zhvillimit social; politikat mbështetëse për nxitjen e zhvillimit të biznesit familjar. Një kontribut të rëndësishëm për promovimin e shëmbujve të mirë të biznesit familjar e jep edhe media, por mediat private rendim më shumë ndaj interesave të pronarëve të vet sesa në promovimin e shëmbujve pozitiv të bizneseve familjare. Gjatë këtij çerek shekulli, rezultojnë se grupet e interesit njohin nga afër nevojat, problemet, pengesat dhe gjithë ciklin social-ekonomik të vendit, si dhe kohët e fundit gjithnjë e më shumë po flitet për rëndësinë dhe kontributin e biznesit femëror si ai familjar ashtu edhe SME.

Buletin Informativ

Korrik 2017

NË KËTË NUMËR

Trajnime Profesionale në Menaxhim Biznesi

DHTI në bashkëpunim me Dhomën Austriake të Tregtisë vijon trainimet për biznesin. Faqe 5



Panairi ndërkombëtar "China Fair 2017"

SHGPAZ merr pjesë në panair me një grup gra sipërmarrëse. Faqe 4



Ditët e Liqenit në Pogradec- Takim me pushtetin lokal



Më data 12-13 korrik 2017 u zhvilluan në Pogradec aktivitete në kuadër të Ditëve të Liqenit.

Në këtë kuadër një grup prej 5

anëtareve të SHGPAZ organizuan një takim me pune me përfaqësues të Pushtetit Lokal të Pogradecit për forcimin e bashkëpunimit në të ardhmen në

dobi të biznesit familjar dhe të ruajtjes së artizanatit lokal.

Takim me ish-sudenten Pashkë Delija, sot aktiviste e shoqërisë civile, Pukë

Nga Flutura Xhabija

Pashke Delia, një ish-studente (sot gjyshe) në vitin 1976-78 në shkollën e lartë të oficerëve. Në këtë shkollë kishte një grup vajzash në degë të ndryshme: këmbësori, prapavijë, kimi etj. Unë i jepja mesimin e gjuhës shqipe dhe frënge, dhe u bera shoqe me to, pa ngaterruar kërkesën e llogarisë mesimore; nder ato ishte Pashka: pak e shkurtër, shumë simpatike, e qeshur, e sinqertë, fizikisht e aftë për ushtrimet ushtarake dhe



inteligjente, e cila më kishte mbetur në memorie.

Aktivizimi me shoqërinë civile e bëri të mundur që pas 40 viteve të takohemi në disa aktivitete në Pukë.

Sot ajo bën pjesë edhe në shoqatën e SHGPAZ dega Pukë.

Samiti i Vendeve të Ballkanit Perëndimor

Samiti i Vendeve të Ballkanit Perëndimor u zhvillua në datën 12 Korrik 2017 në Trieste të Italisë. Në këtë Samit morën pjesë krerët e qeverive, ministrat e Jashtëm dhe Ministrat e Ekonomisë të Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi



e Serbisë, të njohur si WB6, si dhe të vendeve Austri, Kroaci, Francë, Gjermani, Slloveni, SHBA dhe përfaqësues të BE dhe institucioneve financiare.

Shqipëria u përfaqësua në nivelin më të lartë nga Kryeministri Edi Rama, Ministri i Jashtëm z. Ditmir Bushati, Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes znj. Milva Ekonomi si dhe Ministrja e Inovacionit dhe Administratës Publike, znj. Milena Harito.

Pjesëmarrësit njëzëri konfirmuan mbështetjen për perspektivën europiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndërsa theksuan nevojën për përpjekje për

reforma të reja në rajon. U theksua se Ballkani Perëndimor i përket BE-së dhe se BE është e paplotë pa integrimin e plotë të të gjithë rajonit. Lidhur me afrimin me tepër të vendeve të Ballkanit perëndimor, u ra dakord për 7 projekte shtesë konektiviteti me një investim total 500 mln, duke e

çuar fondin total të konektivitetit që nga 2015 në 1.4 mld euro, për gjithsej 20 projekte investimi në total. Shtylla të tjera për të cilat u diskutua ishin: integrimi ekonomik rajonal, zhvillimi i sektorit privat dhe SME-ve, kontektiviteti human, si politikat e përbashkëta për rininë, shkencën, lufta kundër korrupsionit dhe qeverisja e mire, migrimi etj. Fokusi i Samitit ishte zona ekonomike rajonale dhe axhenda ekonomike mes vendeve.


Takim me bordin e SHGPAZ, Pogradec

Datë 24 korrik 2017 u mbajt takimi i bordit të SHGPAZ Pogradec me tematikë planifimi vjeshtor dhe dimëror për gratë sipërmarrëse dhe artizane të Pogradecit. Punët e tyre të paimagjinueshme dhe guximi qytetar i lakmueshëm; pastërtia trupore dhe e mjedisit ku punojnë të lenë pa mend dhe butësia e shpirtit të tyre të bën të ndjehesh gati-gati fajtores, që nuk i ndihmon sa e si duhet. Në tavolinat e drurit ku han drekat e darkat me kuzhinë vendase bio, ti mahnitesh sa të bukur e bëjnë jetën familjare e qytetare keto gra të vullnetshme e shpresëshumë; ato punojnë aq shumë për të nxjerrë të ardhura për shtëpitë e veta dhe të kontribuojnë edhe për qytetin.



Panairi ndërkombëtar “China Fair 2017”

Në
Stamboll të



Turqisë u mbajt
Panairi

Një delegacion me sipërmarrëse të SHGPAZ u përfaqësuan në këtë panair. Panairi ishte i organizuar mjaft mirë, gjallëri e madhe dhe një oportunitet për sipërmarrëset shqiptare.


Ndërkombëtar
China Fair 2017.



Programi i Vetëpunësimit të të rinjve

Programi i Vetëpunësimit mbështet të rinjtë që kanë dëshirën dhe vizionin për të ndërtuar biznesin e tyre. Nëpërmjet trajnimit mbi vetëpunësimin, këshillimeve të vazhdueshme gjatë gjithë fazave të programit, dhe mbështetjes financiare (në formën e pajisjeve dhe / ose materialeve), programi

asiston në transformimin e ideve në biznese të qëndrueshme.



Programi zbatohet nga UNDP me mbështetjen e Qeverisë Svicere.

Trajnime Profesionale në Menaxhim Biznesi

Takime b2b me Bizneset Austriake

Projekte Ndërkombëtare

Bashkëpunim me Bizneset Austriake

Nga Albana Laknori

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCI Tirana), në bashkëpunim me Dhomën Austriake të Tregtisë (WIFI INTERNATIONAL), vijon organizimin e trajnimeve nën brandin ndërkombëtar "WIFI" në Menaxhimin e Sipërmarrjes. Ky është viti i 9^o i organizimit të këtyre kurseve trajnimi i cili ka rezultuar me shumë sukses në ngritjen profesionale të nivelit menaxherial dhe jo vetëm, në rritjen e interesit të sipërmarrjes austriake si dhe në bashkëpunime të ndërsjellta me biznesin shqiptar.

- Si ofrohen këto Kurse?

Programi i trajnimit "WIFI" të ofruara nga CCI Tirana (Chamber of Commerce and Industry of Tirana), janë të organizuara që ti vijë në ndihmë biznesit shqiptar për mundësi më të mëdha bashkëpunimi me bizneset Austriake. Në marrëveshje me WKO dhe CCIT, pjesa më e madhe e kostove të trajnimit përballohet nga partneret, ndërsa pjesëmarrësit në këto trajnim paguajnë një "Fee" simbolike dhe mjaft ekonomike.

- Qëllimi i Programit WIFI-AUSTRIA

Ngritjen profesionale të nivelit menaxherial, me lektore/ekspertë ndërkombëtare, duke ofruar mundësinë e bashkëpunimit dhe partneriteti me sipërmarrje Austriake me qëllim shtimin e eksporteve dhe shitjeve.

- Lektorët

Në këtë program do të ketë një përzgjedhje të lektorëve më të mirë ndërkombëtar (Austriakë) me përvojë të gjatë akademike dhe profesionale në fushën e menaxhimit dhe lidershit.

- Modulet dhe Lektorët

Moduli I^o

Datë: **19-20-21.10.2017**

Strategic Planning / Organizational Skills

Module II^o

Datë: **26 – 27-28 .10.2017**

Risk of Business Management

Module III^o

01-02-03 .11.2017

Innovative Methods in Business, Finance and Marketing

Provimi: 04.11.2017

Vizita në Wien - Austri: 11-15 Dhjetor.2017

- Target Group

Kurset janë të dizenuara për menaxherë apo administratorë të kompanive, të cilët janë të

interesuar për trajnime profesionale me ekspertë ndërkombëtarë. Në këto kurse trajnimi mund të marrin pjesë të gjithë ata përfaqësues të



shoqërive shqiptare, që janë të interesuar për bashkëpunim me sipërmarrjen Austriake në fushat me interes e vecante dhe me mundësi për gjetje partneriteti. Import-Eksport. Eksperienca në këto kurse trajnimi është një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer informacion dhe përvojë.

- Afati i aplikimit 29.09.2017

Për më shumë informacion, ju lutemi drejtoju:

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

Rruga e Kavajës, Nr. 6

Tel: (0) 45 800 934

Cel: [0696088222](tel:0696088222)


Partneriteti qeveri-biznes

Sipërmarrja e dyzuar mes problematikave aktuale dhe optimizmit për të ardhmen

nga **Violeta Shqalsi**

Biznesi është partner kryesor në zhvillimin ekonomik, social, por dhe integrimin e vendit. Kjo është ajo çka thuhet në cdo tryezë apo takim zyrtar të qeverisë qëndrore apo lokale. Por sa partner është me të vërtetë biznesi në aktivitetin ekonomik të vendit. Është quajtur motorri i ekonomisë dhe ndoshta atë që se kanë bërë qeveritë në këto vitet e fundit e ka bërë sipërmarrja vendase dhe e huaj në zhvillimin e vendit. Megjithëse qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit në vend, duhet ende kohë që biznesi të ndryshojë perceptim dhe të krijojë pritshmëritë pozitive mbi klimën e biznesit në një të ardhme të afërt. Edhe pse këto reforma janë ndërmarrë në fusha të ndryshme, janë lehtësuar procedura apo eliminuar barriera, përsëri klima e të bërit biznes në vendin tonë mbetet "e brishtë", ndërkohë që konkurrenca e vendeve fqinje mbetet e lartë në këtë aspekt. Çështjet më problematike mbeten zbatimimi i ligjit, efektshmëria e gjyqësorit, ndryshimi i legjisllacionit dhe atij tatimor në veçanti, stabiliteti i tij, pasi biznesi mendon se ai është kompleks dhe i ndryshueshëm, shpesh i pakutueshëm dhe me vështirësi në zbatim. Për të përmirësuar këtë klimë, do të jetë

miratimi dhe vënia në zbatim sa më shpejt e reformës në drejtësi....Por çfarë pret vete komuniteti i biznesit nga qeveria e re. Sipas përfaqësuesve të dhomave kryesore të tregisë në vend, miratimi i një dikasteri të ri në kabinetin qeveritar, siç është Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është një vlerësim nga ana e kryeministrit i çështjeve dhe problematikave të biznesit. Ndërkohë edhe pse vlerësojnë këtë strukturë, janë "skeptikë" për mënyrën e funksionimit të saj. Gjithashtu një ndër kërkesat e sipërmarrjes për qeverinë e re është qartësimi i politikave fiskale dhe mbajtja e premtimit për uljen e taksave, çka sipas tyre do të bënte vendin tonë më konkurrues në Rajon. Gjithashtu stabiliteti politik në vend shihet si një ndër faktorët kryesorë të përcjelljes së një perceptimi pozitiv për sipërmarrjen si të huaj, ashtu edhe vendase. Sipas Gjergj Buxhukut, Drejtorit Ekzekutiv të Konfindustrias, kërkesat e biznesit për qeverinë e re të dalë nga zgjedhjet e 25 qershorit 2017 janë vështirë të përmbledhen, por duhet të pranojmë, se tashmë sistemi ekonomik i ndërtuar në 26 vjet ka shfaqur qartë probleme të rënda, që lidhen drejtpërdrejt me thelbin e tij. Nuk bëhet më fjalë për rregullime pjesore. Kërkohe detyrimisht ndërhyrje në "zembrën



e tij", që në këtë rast duhet të jenë zgjidhje rrënjësore, që nuk mund ti japi biznesi, por vetëm politika. Sistemi i sotëm nuk është i aftë të sigurojë rritjen e qëndrueshme ekonomike. Mjafon të vlerësojmë, se rritja ekonomike mesatare në 4 vitet e fundit nuk e arrin 3% e PBB dhe nëse do të zbriten, rritja e borxhit te ri prej mbi 1.4 miliard\$, ndikimi i disa projekteve të nisura kohë më parë dhe pa llogaritur ekonominë e trafiqeve, jemi në kushtet e një recesioni të qartë prej mbi 2%. Pasojat shprehen dukshëm në rënien e nivelit real të jetesës së qytetareve në mbi 2%, si dhe fuqinë e ulët në përthithjen e fuqisë së re punëtore. Vendi vazhdon prej pothuaj 3 dhjetëvjeçarësh të mbështetet në të ardhurat nga burimet natyrore të papërpunuara, prodhime manufakture me vlerë të shtuar të ulët, të ardhurat nga emigracioni dhe trafiqet. Një sistem ekonomik i tillë, që është objektivisht i paaftë për të krijuar mirëqenie dhe nuk mban dot qytetaret e tij tregon, se praktikisht ka rënë dhe duhet rindertuar nga fillimi. Politikat fiskale të vendit kanë treguar qartësisht se nuk mbështesin rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investimeve.

FAKTE

26.8%

Biznese aktive të drejtuara/pronare gra, për vitin 2016 në Shqipëri rezultojnë 26.8% me një rënie me 4.5 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%.



3.2%

Rritja e kredisë për vitin 2016 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë.



Pazari i ri në Korçë



Mëngjes korriku në Korçë. E filluam nga pazari i ri i saj, mesatarisht i bukur, të mbyllura shumë dyqane, produkte të huaja, artizanat i varfër, nuk "zien" si dikur...biznesi nuk do komandë, dhe rregullat i vendos vetë.



Gruaja dhe shëndeti

Nishanet

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Sapo ka kaluar vera që këtë vit ishte mjaft e nxehtë dhe me temperatura ekstremisht të larta edhe mbi 40 gradë Celsius. Shpresojmë që t'i keni zbatuar rekomandimet e mjekut për t'u mbrojtur nga ekspozimi për kohë të gjatë në diell, l cili mund të çoj në dëmtim të qelizave të lëkurës, e mund të krijohet kanceri i lëkurës.

Po çfarë janë nishanet?

Shumica e njerëzve kanë një numër të vogël njollash të mbingjyrosura në lëkurën e tyre, që quhen nishane. Zakonisht, i rrituri ka të paktën 25 nishane në lëkurën e tij. Vetëm pak prej tyre ekzistojnë që nga lindja, më të shumtët shfaqen me kalimin e kohës. Shumica e nishaneve janë dhe mbeten të parrezikshëm e të padëmshëm gjatë gjithë jetës së njeriut. Por, një ndryshim në një nishan ose në ndonjë njollë tjetër të lëkurës mund të jetë shenja e parë paralajmëruese e një melanome. Shenjat paralajmëruese janë: "Ndryshimi i nishaneve në madhësi, në ngjyrë, në formë, në sipërfaqe, në ndjeshmëri, përreth tij, etj".

Gratë janë më të rrezikuara nga melanoma me një shkallë rreziku në 1 me 20, ndërsa shkalla e rrezikut për meshkujt është më e ulët në 1 me 50.

Zonat më të prekura prej melanomës janë: "Këmbët te

femrat, kurrizi në meshkuj, fytyra në moshën e tretë. Por, thuhet që melanoma mund të zhvillohet kudo, ndonjëherë edhe në pjesët e trupit të pa-ekspozuara në diell, si për shembull në shputat e këmbëve, ose në të ndenjura. Ndaj është e këshillueshme që të jeni të kujdesshëm dhe të mos neglizhoni asnjëherë kontrollin e nishaneve. Kontrolli i rregullt i lëkurës nga vetë ju është mënyra më e mirë për të njohur nishanet tuaja. Me ndihmën e një personi të afërm, mund të shikoni dhe zonat të cilat nuk mund t'i kontrolloni vetë.

Ndryshimi i ngjyrës, formës, rritja e nishaneve, skuqja, gjakrrjedhja ose shfaqja e pigmentimit tërësisht të ri mund të jenë shenja paralajmëruese. Çdo ndryshim ose shfaqja e ndonjë ndryshimi të pigmentuar në lëkurë duhet të raportohet te mjeku. Specialisti dermatolog duhet të bëjë kontroll komplet të të gjitha ndryshimeve të pigmentuara në trup. Një nga mënyrat e shkëlqyeshme është që ndryshimet të incizohen me teknikë digjitale –dermoskopike dhe në këtë mënyrë të shihen strukturat delikate të lëkurës dhe çrregullimi i pigmentimit. Dermoskopia nuk shkakton dhimbje dhe mundëson që të shihen strukturat delikate të lëkurës dhe çdo çrregullim i pigmentimit.



Më të rrezikuar janë personat që kanë numër të madh nishanesh, mbi 100 në të rinjtë dhe mbi 50 në të moshuarit, ata që kanë nishane jo të zakonshme që paraqesin ndryshime, personat me histori familjare për melanomë, personat që kanë shfaqur në të kaluarën tumor të lëkurës, ata që kanë lëkurë të çelët ose shumë të çelët, e cila digjet lehtë ose nxihet pak, personat që kanë ngjyrë flokësh të çelët (biond) ose të kuq dhe sy me ngjyrë të çelët, personat që janë ekspozuar në diell për një kohë të gjatë, ata që kanë kaluar djegie nga dielli në fëmijëri, ose në moshë të rritur, si dhe personat që kanë punë në ambient të hapur ose pëlqejnë aktivitet e shpeshta në natyrë.

Kanceri i lëkurës është mjaft i përhapur në Shqipëri dhe renditet i dyti pas kancerit të zorrës së trashë. Melanoma është një nga llojet më të rrezikshme të kancerit të lëkurës duke shkaktuar rreth 75% të vdekjeve nga të gjitha format e kancerit të lëkurës dhe duke u konsideruar kështu si një problem i madh social.

Prandaj, bëni kontroll të nishaneve tuaja dhe për çdo dyshim paraqituni tek specialisti.

Vila Melko-artizanati, biznesi dhe turizmi



Tek Vila Melko në Boboshticë janë të punësuar rreth 90 % gra, ku shërbehen produkte bio madje nga vetë fshati ku ishte vila. Provojeni dhe do kënaqeni!



Takim me degën e shoqatës “Lion”

Më 26 korrik 2017, Presidentja e SHGPAZ, znj.Flutura Xhabija u takua me presidenten e shoqatës “Lion” për bashkëpunimin në të ardhmen.



Takim i presidenteve të tre shoqatave



23 KORRIK 2017. Takim i tre shoqatave të shoqërisë civile më të rëndësishme të Shqipërisë, për të diskutuar rreth arritjes së qëllimit të financimit të rrugës prej 3 km dhe parkut tek ishulli i Lezhës, që shkon edhe drejt biznesit të Diellës në Kune Vahinë, të cilën e vizituam gjatë

muajit prill 2017. Pas asaj vizite dhe parjes në vend të gjëndjes së rrugës, të tre shoqatat realizuan disa takime në nivel qendror e lokal dhe kjo bëri të mundur financimin e ndërtimit të rrugës, e cila tashmë ka filluar dhe pritet të përfundojë Brenda një periudhe 1 vjeçare. Përmirësimi i infrastrukturës do të zhvillojë më tej bizneset e zonës, ruan mikroklimën e zonës dhe lehtëson turizmin në çdo stinë.



Vizitë tek sipërmarrësja Monda Guxholli

Monda Guxholli, lindur e rritur në Pogradec, e po këtu jeton; e filloi sipërmarrjen që në vitin 1990, ndonëse ishte me dy femijë shumë të vegjël dhe vetë mjaft e re. Së pari e nisi me tregti, me ndërtim, me gjithcka çfarë ofronte ekonomia e uritur shqiptare. Monda me të shoqin, i përdornin makinat (të vogla e të mëdha) më lehte se biçikletat, madje femijte e saj, që në moshën 9 vjeç ngisnin veturat. Për këtë në Pogradec, qarkullon ende historia e djalit të Mondës, i cili në moshën 11 vjeçare ngiste

veturën dhe një herë habiti policin rrugor i cili, nuk shihte shoferin, por një makinë që lëvizte vetë; iu afrua dhe pa nje djalë të vogël që voziste kaq lehtësisht mjetin, i sigurt edhe i saktë. Familja punonte e gjitha, funksiononte biznesi familjar dhe Monda nuk ndalej; pas disa viteve filloi përzgjedhja, ai i abazhureve në Stamboll. Por këtë sektor e njihnin të gjithë dhe ajo zgjidhte pjesët më të bukura; hapi një dyqan, pastaj të dytin e të tretin, në Pogradec; e hapi në Tiranë, tani e menaxhon i biri; e hapi në Korçën naziqe, njëdy dyqane,

por të tjera do të hapë; ajo nuk e ndal hapin! Nderim për njerëzit punetorë, të guximshëm dhe vizionarë.



Buletin Informativ

Korrik 2017



Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com

Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia